

VENDIM
Nr. 33, datë 30.5.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 30.5.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (N) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: NAZIF SPAHIU

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI I MINISTRAVE,

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË,

AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE DHE

INFRASTRUKTURËS SË MBETJEVE,

AVOKATURA E SHTETIT

OBJEKTI: shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1435, datë 23.6.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: nenet 18, pika 1, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “P”, 134 dhe pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave, Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (*AKUM*) dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (*MIE*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuar është pronar i pasurisë së paluajtshme të identifikuar sipas të dhënave të regjistrit të pasurive të paluajtshme me nr. 203/5, zona kadastrale nr. 3866, vol. 19, faqja 218, e llojit “arë”, me sipërfaqe 3000 m², të ndodhur në Yzberisht. Me vendimin nr. 61, datë 12.2.2014 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të Tiranës së Madhe”, Këshilli i Ministrave ka miratuar shpronësimin e 52 pronarëve të pasurive të paluajtshme të

konfirmuara nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Tiranë, nga 155 pronarë që kanë rezultuar në planimetrinë e shpronësimit. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve (DPUK) i është drejtuar Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve (KPSH) në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), duke kërkuar përfshirjen në procesin e shpronësimeve të 9 pasurive të tjera tokë “arë”, përfshirë edhe atë të kërkuarit. Kjo kërkesë është miratuar nga KPSH-ja më datë 19.5.2015, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 7.288.512 lekë.

2. Në vijim, me vendimin nr. 772, datë 16.9.2015 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të Tiranës së Madhe (shtesa)”” (VKM nr. 772/2015), të publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 168, datë 25.9.2015, është vendosur shpronësimi për interes publik i pronarëve të pasurive që preken nga zbatimi i këtij projekti, ku në pikën 9 të listës bashkëlidhur VKM-së rezulton edhe emri i kërkuarit. Sipas kësaj liste, nga vlerësimi i bërë në lidhje me pronarët dhe pasuritë që do të shpronësohen, rezulton se sipërfaqja e shpronësimit për pasurinë e kërkuarit është 3.000 m² me një çmim prej 448 lekë/m² dhe vlerë totale përfitimi për shkak të shpronësimit 1.344.000 lekë. Po kështu, përmes kësaj VKM-je janë urdhëruar Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe ZVRPP-ja, Tiranë që, me fillimin e procesit të likuidimit, të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

3. Në kushtet kur sipas institucioneve shtetërore dhe legjislacionit në fuqi përcaktohetin regjime të ndryshme juridike për pronën e tij, më datë 13.10.2015, bazuar në nenin 153 të Kodit Civil (KC), ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” (ligji nr. 8561/1999) dhe ligjin nr. 49/2012, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012), kërkuari i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shfuqizimin e pjesshëm të VKM-së nr. 772/2015, konkretisht të pikës 9 të listës së pronarëve që shpronësohen nga ky projekt në tabelën e vlerësimeve, për sa i takon çmimit të shpronësimit të tij në një vlerë 448 lekë/m², si dhe shpronësimin e tij në vlerën 150 euro/m², sipas çmimeve të tregut; detyrimin solidar të të paditurve, DPUK-së dhe MTI-së, t’i paguajnë shumën 150 euro/m², minus çmimin e akorduar me VKM-në nr. 772/2015, 448 lekë/m².

4. Gjatë gjyimit të çështjes nga gjykata e shkallës së parë, për referimin e çmimit të tregut në të cilën ndodhet pasuria, kërkuari, në cilësinë e provës, ka paraqitur një kontratë shitblerjeje të një pasurie tokë “arë” të ndodhur në të njëjtën zonë kadastrale me pasurinë e tij, sipas së cilës vlera e shitjes është 80 euro/m². Eksperti i caktuar nga gjykata për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të kërkuarit ka konkluduar se regjimi juridik i tokës ka ndryshuar nga “arë” në “trull”, ndërsa ajo është pjesë e planit të përgjithshëm vendor të Komunës Kashar, miratuar me vendimin nr. 17, datë 10.5.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe bën pjesë në nënnjësinë strukturore 10/15, për të cilën parashikohet “infrastrukturë/utilitete/kanalizime”, kurse për zonat kufitare parashikohen “zona rezidenciale, tregje dhe shërbime”. Sipas ekspertit, referuar VKM-së nr. 514, datë 30.7.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (VKM nr. 514/2014), çmimi për m² për pasurinë “trull” të kërkuarit është 4.242 lekë/m², për rrjedhojë vlera totale e pronës objekt i gjyimit është 12.726.000 lekë. Po sipas ekspertit, duke përdorur metodën e krahasimit të drejtpërdrejtë, referuar kriterëve të vlerësimit, si dhe duke pasur parasysh një vlerësim të mëparshëm të saj (3.500 lekë/m²) në vitin 2010, në rastin e vendosjes së pronës në hipotekë nga kërkuari për marrjen e një kredie bankare në shumën 75.000 euro, vlera e kësaj prone përlllogaritet 5.000 lekë/m² ose me një vlerë totale 15.000.000 lekë.

5. Në analizë të akteve normative në fuqi për shpronësimin për interes publik, për përcaktimin e kuptimit të tokës “trull” e të regjimit juridik të saj, për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen për interes publik, të pretendimeve të kërkuarit, sipas të cilit vlera e pronës është shumë më e lartë sesa ajo e caktuar me VKM-në nr. 772/2015, si dhe të pretendimeve të palëve të paditura, që kanë prapësuar se vlerësimi i pronës së kërkuarit është bërë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi,

gjykata e shkallës së parë ka çmuar se në përcaktimin e çmimit për m² të pronës së kërkuarit duhej t'i referohej VKM-së nr. 514/2014, e cila ka qenë në fuqi në kohën e shpronësimit (*shih vendimin nr. 6446, datë 21.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, faqja 13*).

6. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 6446, datë 21.12.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; ndryshimin pjesërisht të VKM-së nr. 772/2015, për sa i përket vlerës së shpronësimit për pasurinë në pronësi të kërkuarit, detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë vlerën prej 11.382.000 lekësh, si diferencë ndërmjet çmimit të shpronësimit dhe vlerës së akorduar për këtë shpërblim me VKM-në nr. 772/2015; ekzekutimin nga pala e paditur të këtij vendimi brenda një viti nga marrja e vendimit formë të prerë dhe mbi kërkesën e kreditorit, pagimin e vlerës së detyrimit në dy keste me afat gjashtë muaj secili, ndërsa ekzekutimi i detyrueshëm i tij do të bëhet nga përmbartuesi gjyqësor. Sipas gjykatës, toka e shpronësuar e kërkuarit konsiderohet nga ligji si truall, pasi ajo ndodhet brenda vijave kufizuese të qytetit, referuar vendimit nr. 1, datë 1.6.2006 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, për miratimin e studimit urbanistik të zonës në përfundim të qytetit të Tiranës (Komuna Kashar), me sipërfaqe 235.5 ha, si dhe vendimit tjetër të tij nr. 5, datë 3.9.2010, për miratimin e studimit urbanistik për zonat "A", "C", "D", "E" dhe "F", sipas studimit urbanistik të zonës në përfundim të qytetit të Tiranës (Komuna Kashar, qarku Tiranë). Në lidhje me pretendimin tjetër të kërkuarit, gjykata ka arsyetuar se koncepti i shpërblimit të drejtë nuk prezumon realizimin e interesave më të lartë ekonomike të subjekteve dhe se shpërblimi i drejtë që duhet t'i akordohet kërkuarit është 11.382.000 lekë, si diferencë mes vlerës 12.726.000 lekë dhe asaj 1.344.000 lekë, të caktuar me VKM-në nr. 772/2015. Kërkuari ka paraqitur ankim kundër vendimit të kësaj gjykate, duke pretenduar, ndër të tjera, se vlera e përcaktuar nga gjykata e shkallës së parë nuk është e plotë, pasi nuk pasqyron vlerën e pasurisë sipas çmimit të tregut. Po kështu, kanë ushtruar ankim edhe palët e paditura, MTI-ja dhe Avokatura e Shtetit. Me vendimin nr. 1779, datë 26.4.2018, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e gjetur atë të drejtë e të bazuar në ligj, si dhe në vlerësim të saktë të fakteve dhe veprimeve të lidhura me mosmarrëveshjen.

7. Për rekursin e paraqitura nga kërkuari, MIE-ja, AKUM-i dhe Avokatura e Shtetit, me vendimin nr. 00-2022-1435, datë 23.6.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tyre, duke vlerësuar se nuk përmbajnë shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, pasi nuk ngrenë problematika për zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural nga gjykatat më të ulëta dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Po sipas tij, Gjykata Administrative e Apelit u ka dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në rekurs, përmes një analize të hollësishme të dispozitave ligjore që rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim, ndërsa për sa u përket pretendimeve të palëve që kanë ngritur çështje të vlerësimit të provave, gjykata ka vlerësuar se ato dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj (*shih vendimin nr. 00-2022-1435, datë 23.6.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqja 10, paragrafët 25-26*).

8. Më datë 24.10.2022 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit të tij. Më datë 16.12.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

9. Me vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 13.9.2017 dhe nr. 111, datë 2.3.2022 kompetencat e MTI-së i kanë kaluar MIE-së, ndërsa me vendimin nr. 431, datë 11.7.2018 të Këshillit të Ministrave, DPUK-ja është transformuar në AKUM. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi, emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që janë kryer veprimet prej tyre.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

10.1 E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

10.1.1 *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj* në lidhje me *standardin e arsytimit të vendimit*. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar për ndryshimet e fundit ligjore në lidhje me përbërjen e trupave gjykues dhe procedurën e gjykimit të çështjeve, ndërkohë që duhej të kishte zbatuar rregullimet ligjore të vitit 2015, kur është paraqitur kërkesëpadia dhe është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave, pasi ligji nuk ka fuqi prapavepruese.

10.1.2 *Së drejtës për akses substancial*, për shkak të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë. Çështja duhej t'i nënshtrohej debatit në seancë gjyqësore, pasi kolegji i kësaj gjykate nuk mund t'i zgjidhte problematikat e saj në dhomën e këshillimit.

10.2 *E drejta e pronës private*, si rrjedhojë e çmimit me të cilin është vlerësuar financiarisht prona e tij përmes VKM-së nr. 772/2015, në kuadër të shpronësimit për interes publik. Vlera e pronës së shpronësuar është disa herë më e lartë sesa ajo e caktuar nga shteti dhe nuk i përgjigjet shpërblimit të plotë të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe neni 153 i KC-së. Kompensimi i drejtë është ai sipas vlerës së tregut. Në caktimin e vlerës së pronës gjykatat nuk kanë marrë parasysh cilësitë e pronës dhe mundësinë e zhvillimit të saj. Për më tepër, gjykatat e kanë dëmtuar më tej, si rrjedhojë e urdhërimit të shtetit për pagimin e shumës me këste.

11. *Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit*, kanë prapësuar:

11.1 Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes, pasi ajo ka të bëjë me faktet dhe interpretimin e zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe nuk shfaq problematikë të natyrës kushtetuese. Pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë me mospërputhjen e vlerës së shpërblimit të caktuar për pronën me vlerën që, sipas tij, ka pasur pasuria në treg, çka përbën çështje fakti, për rrjedhojë nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.

11.2 Kufizimi i së drejtës së pronës është bazuar në ligjin nr. 8561/1999. Ndërhyrja është bërë për një interes publik, ndjek një qëllim legjitim dhe është proporcionale. Masa e shpërblimit është nxjerrë mbi bazë dhe në zbatim të ligjit, akteve nënligjore, procedurave dhe metodikave ligjore. Kriteri për shpërblimin e pronësisë së shpronësuar nuk mund të jetë “i plotë”, por “i drejtë” dhe kërkuari është shpërblyer në mënyrë të drejtë. Vlera e akorduar është proporcionale.

12. *Subjekti i interesuar, AKUM-i*, ka prapësuar:

12.1 Këshilli i Ministrave ka përcaktuar çmimet për tokën bujqësore me vendimin nr. 187, datë 6.3.2013, sipas të cilit, për zonën ku ndodhet pasuria e kërkuarit, është përcaktuar vlera 448 lekë/m². Gjykata administrative e shkallës së parë ka kapërcyer të drejtën që i ka dhënë ligji, duke ndryshuar vendimin e Këshillit të Ministrave si për sa i përket masës së shpërblimit, ashtu edhe llojit të pasurisë. Ajo ka ndryshuar regjimin juridik të tokës në kundërshtim me ligjin nr. 8561/1999, i cili parashikon të drejtën e pronarit të shpronësuar për të kundërshtuar gjyqësisht vetëm masën e shpërblimit të caktuar. Sipas certifikatës së pronësisë, prona e kërkuarit rezulton tokë “arë”.

12.2 Pretendimi i kërkuarit për vlerën e pronës është i pabazuar, pasi çmimi i përcaktuar në VKM-në nr. 772/2015 gjen mbështetje ligjore në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000. Privimi nga e drejta e pronësisë e detyron shtetin të shpërblejë pronarin me një shpërblim të drejtë, por jo domosdoshmërisht me një vlerë tregu.

12.3 Gjykata e Lartë duhej të kishte vendosur ndryshimin e vendimeve të shkallës së parë e të apelit dhe të pranonte rekursin e AKUM-it.

13. *Subjekti i interesuar, MIE-ja*, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për

gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 12, datë 9.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata vëren se pretendimet në lidhje me procesin e rregullt ligjor kanë të bëjnë me vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor, ndërsa pretendimet për të drejtën e pronës private kërkuesi i ka ngritur më parë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në kushtet kur për pretendimet për procesin e rregullt ligjor nuk ka më mjete të tjera në dispozicion, si dhe ato për të drejtën e pronës i ka ngritur në gjykatat e zakonshme, Gjykata vlerëson se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

18. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i Gjykatës së Lartë i kundërshtuar nga kërkuesi, i cili mban datën 23.6.2022, është bërë i disponueshëm për palët më datë 20.7.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë më datë 24.10.2022, për rrjedhojë kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* në kërkesën e tij, sipas objektit.

19. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, Gjykata evidenton se ndërsa sipas objektit të ankimit kushtetues individual kërkuesi kundërshton vetëm vendimin e Gjykatës së Lartë, në përmbajtje të tij ai kundërshton edhe vendimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, që kanë vendosur për vlerën e shpronësimit të pasurisë së tij për interes publik, duke pretenduar se i kanë cenuar të drejtën e pronës private.

20. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se Gjykata nuk ka juridiksion, pasi çështja ka të bëjë me faktet dhe interpretimin e zbatimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe nuk shfaq problematikë të natyrës kushtetuese. Pretendimet e kërkuetit kanë të bëjnë me mospërputhjen e vlerës së shpërblimit të caktuar për pronën me vlerën që, sipas tij, ka pasur pasuria në treg, çka përbën çështje fakti, për rrjedhojë nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.

21. Gjykata rithekson se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore, raste në të cilat Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i

gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 7, datë 7.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se, në kundërshtim nga sa pretendohet nga subjektet e interesuara, pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual përfshihen brenda juridiksionit kushtetues dhe kërkuksi legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me to. Për sa u takon pretendimeve të kërkuksit për procesin e rregullt ligjor, të ngritura në kuadër të përbërjes së trupit gjykues të Gjykatës së Lartë dhe shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me parimin *tempus regit processum*, duke zbatuar legjislacionin në fuqi në kohën e shqyrtimit të rekursit, i cili ka përcaktuar përbërjen e trupit gjykues me 3 gjyqtarë, si dhe shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit ose në seancën plenare, në varësi të natyrës së çështjes dhe pretendimeve të ngritura (*shih nenin 1, 61 dhe 62, pika 1, të ligjit nr. 49/2012 dhe nenin 35 të Kodit të Procedurës Civile*). Në këtë kuptim, Gjykata çmon se argumentet e parashtruara nga kërkuksi janë të pamjaftueshme për të mbështetur pretendimet për cenimin e procesit të rregullt ligjor në këto aspekte, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

23. Për sa u përket pretendimeve të tjera lidhur me të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe me të drejtën e pronës, duke pasur parasysh thelbin e tyre, Gjykata çmon t'i analizojë ato në themel në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit dhe të drejtën e pronës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit dhe të drejtën e pronës

24. Kërkuksi ka pretenduar se vlera e pronës së shpronësuar është disa herë më e lartë sesa ajo e caktuar nga shteti dhe nuk i përgjigjet shpërblimit të plotë të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe neni 153 i KC-së. Sipas tij, kompensimi i drejtë është ai sipas vlerës së tregut. Në caktimin e vlerës së pronës gjykatat nuk kanë marrë parasysh cilësitë e pronës dhe mundësinë e zhvillimit të saj. Për më tepër, gjykatat e kanë dëmtuar më tej, si rrjedhojë e urdhërimit të shtetit për pagimin e shumës me këste.

25. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se në rastin e kërkuksit kufizimi i së drejtës së pronës është bazuar në ligjin nr. 8561/1999. Ndërhyrja është bërë për një interes publik, ndjek një qëllim legjitim dhe është proporcionale. Masa e shpërblimit është nxjerrë mbi bazë dhe në zbatim të ligjit, akteve nënligjore, procedurave dhe metodikave ligjore. Kriteri për shpërblimin e pronësisë së shpronësuar nuk mund të jetë “i plotë”, por “i drejtë” dhe kërkuksi është shpërblyer në mënyrë të drejtë. Vlera e akorduar është proporcionale.

26. Subjekti i interesuar, AKUM-i, ka prapësuar se gjykata administrative e shkallës së parë ka kapërcyer të drejtën që i ka dhënë ligji, duke ndryshuar vendimin e Këshillit të Ministrave si për sa i përket masës së shpërblimit, ashtu edhe llojit të pasurisë. Ajo ka ndryshuar regjimin juridik të tokës në kundërshtim me ligjin nr. 8561/1999, i cili parashikon të drejtën e pronarit të shpronësuar për të kundërshtuar gjyqësisht vetëm masën e shpërblimit të caktuar. Sipas certifikatës së pronësisë, prona e kërkuksit rezulton tokë “arë”. Po sipas këtij subjekti, pretendimi i kërkuksit për vlerën e pronës është i pabazuar, pasi çmimi i përcaktuar në VKM-në nr. 772/2015 gjen mbështetje ligjore në VKM-në nr. 138/2000. Privimi nga e drejta e pronësisë e detyron shtetin të shpërblejë pronarin me një shpërblim të drejtë, por jo domosdoshmërisht me një vlerë tregu.

27. E drejta e individit të shpronësuar për të pasur akses në gjykatë, e cila është e parashikuar shprehimisht në nenin 41, pika 5, të Kushtetutës, është garanci specifike e së drejtës së pronës, kur kjo e fundit kufizohet nga shteti me anë të shpronësimit. Me anë të kësaj garancie procedurale, të shpronësuarit i jepet mundësia të përmbushë edhe garancinë tjetër kushtetuese me natyrë materiale – atë të shpërblimit të drejtë. E thënë ndryshe, e drejta e aksesit lidhet nga pikëpamja organike dhe funksionale me shpërblimin e drejtë. Aksesit në gjykatë i të shpronësuarit duhet të garantojë në nivelin e duhur ushtrimin e të drejtave të tij, si mjeti i vetëm me anë të të cilit ai mund të mbrohet në rast arbitrariteti të ndërhyrjes shtetërore, si dhe për të siguruar që kjo

ndërhyrje në të drejtën e pronës private ka qenë proporcionale (*shih vendimin nr. 22, datë 25.4.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Po kështu, në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 11, datë 24.5.2022; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 11, datë 10.3.2023; nr. 9, datë 23.2.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata vëren se neni 41 i Kushtetutës, i cili garanton të drejtën e pronës, në pikën 3 parashikon edhe shpronësimin për interes publik. Ashtu siç është trajtuar në praktikën kushtetuese, koncepti kushtetues i interesit publik është mjaft i gjerë dhe vlerësohet nga Gjykata në këndvështrim të aktit konkret që paraqitet për kontroll përpara saj, pasi është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyen publike që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore (*shih vendimet nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 16, datë 1.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, koncepti i “shpërblimit të drejtë”, i parashikuar në pikën 4 të nenit 41 të Kushtetutës, është interpretuar nga Gjykata në kontekstin e ndërhyrjeve në të drejtën e pronësisë të subjekteve të shpronësuara gjatë regjimit komunist lidhur me konceptet kushtetuese që kanë të bëjnë me interesin publik, si dhe respektimin e parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 4, datë 15.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Ndonëse neni 41 i Kushtetutës nuk ka përcaktuar kriteret që duhen zbatuar për përcaktimin e “shpërblimit të drejtë”, treguesit konkretë për vlerësimin e dëmit të shkaktuar, ose mekanizmat e nevojshëm për shpronësimin për interes publik, kushtetutëbërësi i ka lënë ato në diskrecion të ligjvënësit. Kështu, sipas ligjit nr. 8561/1999, shpronësimi i pasurive pronë private për një interes publik bëhet në ato raste kur interesi publik mbizotëron kundërt interesave privatë të pronarëve të tyre. Ai kryhet në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, në atë masë sa është e domosdoshme për realizimin e qëllimit të shpronësimit dhe në çdo rast përkundërt shpërblimit të drejtë (*neni 2*). Një ndër shkaqet e shpronësimit, sipas këtij ligji, është edhe realizimi i projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore në funksion të infrastrukturës, në shërbim dhe interes të publikut (*neni 8, shkronja “ç”*). Vlerësimi i objekteve që shpronësohen kryhet nga komisioni i posaçëm i ngritur nga ministri kompetent, duke marrë parasysh vlerën fillestare të pasurisë që shpronësohet, amortizimin, destinacionin, vendndodhjen e objektit, indekset e ndryshimit të çmimeve të tregut dhe monedhës, ndërkohë që Këshilli i Ministrave përcakton kriteret e tjera teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit (*neni 17*). Mbi bazën e vlerës që rezulton nga vlerësimi përfundimtar i objekteve që shpronësohen, përllogaritet masa e shpërblimit përkatës, në masë të njëjtë me vlerën e plotë të tij (*neni 19*).

31. Bazuar në rrethanat e çështjes në shqyrtim, Gjykata konstaton se sipas certifikatës për vërtetimin e pronësisë, kërkuesi ka qenë pronar i një pasurie me sipërfaqe 3.000 m², tokë “arë”. Më pas, për zonën ku kjo pasuri ndodhet është miratuar një studim urbanistik, në zbatim të të cilit, përmes instrumentit të përgjithshëm vendor, janë parashikuar ndërtime në “infrastrukturë/utilitete/kanalizime”, kurse për zonat kufitare “zona rezidenciale, tregje dhe shërbime”. Më tej, në kuadër të realizimit të projektit për interes publik të përmirësimit të sistemit

të kanalizimit të Tiranës së Madhe (shitesa), i cili prekte edhe pronën e kërkuarit, është vendosur shpronësimi i tij në këtë pasuri në vlerën 448 lekë/m², me një vlerë totale të shpronësimit të pasurisë 1.344.000 lekë. Duke mos qenë dakord me masën e shpërblimit të caktuar në VKM, kërkuari i është drejtuar gjykatës administrative të shkallës së parë me kërkesëpadi për shfuqizimin e saj, në pjesën që ka përcaktuar çmimin për m² për pasurinë e tij, duke pretenduar se vlera e tregut për këtë pasuri është 150 euro/m².

32. Në vendimin për çështjen, gjykata administrative e shkallës së parë ka arsyetuar se në rastin e kërkuarit ndërhyrja në të drejtën e pronës private është bërë me ligj dhe ndjek një qëllim legjitim, atë të përmbushjes së objektivave të interesit publik. Ajo ka identifikuar ligjin nr. 8561/1999, si ligjin e zbatueshëm, mbi bazën e të cilit janë nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në lidhje me përcaktimet e vlerës së pronës për secilin qark të vendit, të vlerave respektive të shpronësimit sipas llojit të pasurisë, si dhe të vlerës së shpronësimit për interes publik të pasurisë së kërkuarit. Gjykata ka arsyetuar se koncepti i “shpërblimit të drejtë” nuk prezumon realizimin e interesave ekonomike më të lartë të subjekteve, në vlerësim të të gjithë parametrave investues të pronës që shpronësohet, por pronarit duhet t’i kthehet një masë shpronësimi e kënaqshme për standardet ekonomike dhe sociale, në kohën kur kryhet ky shpronësim (*shih vendimin nr. 6446, datë 21.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, faqja 14, paragrafi 3*). Në përfundim të gjykimit të çështjes, bazuar në gjetjet sipas aktit të ekspertimit dhe aktet ligjore në fuqi, gjykata ka përcaktuar vlerën 11.382.000 lekë për shpronësimin e pasurisë së kërkuarit, si diferencë mes çmimit të shpronësimit dhe vlerës së akorduar për shpërblim me VKM-në nr. 772/2015. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është vlerësuar si i drejtë nga gjykata e apelit, me të njëjtin argument (*shih vendimin nr. 1779, datë 26.4.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit, faqja 28, paragrafi 2*), ndërsa për rekurset e ushtruara nga kërkuari, AKUM-i, MTI-ja dhe Avokatura e Shtetit, me vendimin nr. 00-2022-1435, datë 23.6.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tyre, duke vlerësuar, ndër të tjera, se shkaqeve të parashtruara në rekurs u është dhënë përgjigje e hollësishme nga gjykata e apelit.

33. Gjykata konstaton se në kohën e gjykimit të çështjes së kërkuarit, metodologjia e vlerësimit të pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë përcaktohej nga VKM-ja nr. 658, datë 26.9.2012, mbi bazën e së cilës, me VKM-në 514/2014, është miratuar vlera e pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë, ku çmimi për pasurinë truall është përcaktuar në vlerën 4.242 lekë/m². Në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi në kohën e shpronësimit të pasurisë objekt i këtij ankimi kushtetues individual, Gjykata vëren se vlerësimi i pasurisë së kërkuarit është bërë në përputhje me këto akte, ndërsa vlera e akorduar atij për shkak të shpronësimit nga gjykatat e zakonshme është e arsyeshme dhe e mjaftueshme, duke pasur parasysh humbjen e pësuar nga shpronësimi. Për më tepër, kjo vlerë nuk rezulton të jetë më e vogël sesa ajo e përcaktuar për këtë pronë në rastin e vendosjes së saj në hipotekë për garantimin e kredisë bankare të dhënë kërkuarit.

34. Për sa i përket arsyetimit të vendimit, të lidhur me parimin e kontradiktoritetit, Gjykata vëren se kërkuari i është dhënë mundësia të parashtojë pretendimet e tij për sa i përket vlerës së shpronësimit, të cilat janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e zakonshme, përkundrajt prapësimeve të paraqitura nga palët e interesuara. Në përfundim të gjykimit të çështjes, bazuar në legjislacionin në fuqi, gjykatat kanë dhënë përgjigje të argumentuara për vendimmarrjet e tyre, qoftë për sa i takon llojit të pasurisë së kërkuarit, ashtu edhe për sa i takon vlerësimit të saj për qëllime të shpronësimit për interes publik, në garantim të së drejtës së kërkuarit për akses substancial. Metodologjia e përdorur nga gjykatat në përcaktimin e vlerës së shpronësimit të pasurisë së kërkuarit nuk shfaq probleme në aspektin kushtetues dhe interpretimi që gjykatat i kanë bërë konceptit kushtetues të “shpërblimit të drejtë” nuk rezulton të jetë arbitrar ose në cenim të së drejtës së kërkuarit për pronë private.

35. Për rrjedhojë, në këndvështrim të kësaj analize, Gjykata konkludon se gjykatat e zakonshme kanë vepruar në respektim të së drejtës së kërkuarit për akses substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit dhe të drejtën e pronës, ndaj i vlerëson pretendimet e tij të papabazuara.

36. Në përfundim, Gjykata çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit, sipas arsytimit të mësipërm, është i pabazuar, ndaj duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.5.2023.

Shpallur më 29.6.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes, që i përket kërkuesit Nazif Spahiu, me objekt: *“Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1435, datë 23.6.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë”*, ndajmë mendim të ndryshëm me shumicën në trajtimin kushtetues të çështjes, për rrjedhojë parashikojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë paralel.

2. Sipas nenit 131/f të Kushtetutës, përmbajtja e së cilës është ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

3. Ndërkohë që bashkohemi me shumicën, për sa i përket përfundimit të arritur, për rrëzimin e kërkesës, ndajmë qëndrim të ndryshëm në lidhje me trajtimin kushtetues të pretendimeve të kërkuesit, në drejtim të përcaktimit të së drejtës kushtetuese që gjen zbatim në rastin e tij. Në zbatimin e dispozitës kushtetuese të sipërcituar, në rastin e kërkuesit shumica e ka kufizuar kontrollin kushtetues në aspekt të të drejtave procedurale lidhur me të drejtën substanciale të pronës (*shih paragrafin 23 të vendimit*), duke marrë në analizë pretendimet e tij në drejtim të së drejtës për akses substancial në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit dhe të drejtën e pronës, ndërkohë që si gjatë gjyqimit të çështjes nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ashtu edhe gjatë shqyrtimit kushtetues të saj, pretendimet kryesore kishin të bënin me të drejtën substanciale të pronës dhe shpërblimin e drejtë.

4. Në vlerësimin tonë, qëndrimi i shumicës nuk reflekton ashtu siç duhet kompetencën tashmë të zgjeruar të Gjykatës për shqyrtimin e pretendimeve të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Gjykata ka detyrimin e interpretimit të kompetencave të saj kushtetuese, sipas frymës dhe shkronjës së nenit 131/f të Kushtetutës, të ndryshuar. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa proces të rregull ligjor. Ndërkohë, kreu II e në vijim i Kushtetutës, parashikon të drejtat dhe liritë

themelore, (neni 21–neni 58), të natyrës substanciale, të natyrës procedurale, dhe disa të drejta të ndërthurura mes atyre të natyrës substanciale dhe procedurale.

5. Përmes ankimit kushtetues individual kërkuesit mund të paraqesin kërkesë kushtetuese, duke synuar: i) shfuqizimin e një ligji ose akti normativ nënligjor, pasi kanë shteruar mjetet efektive ose kur mjetet janë joefektive (*shih vendimin nr. 31, datë 4.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*); ii) shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, që kanë ardhur si rezultat i një ligji ose akti normativ antikushtetues (*shih vendimin nr. 4, datë 21.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*); iii) shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, që kanë ardhur si rezultat i interpretimit antikushtetues të ligjit ose akteve normative, në zbatim nga organet administrative dhe gjykatat e zakonshme. Kjo mundësi e tretë do të thotë se Gjykata duhet të kontrollojë nëse interpretimi i ligjit procedural dhe substancial, me të cilën ka zgjidhur çështjen gjykata e zakonshme, është antikushtetues, pra jo përmbajtja e ligjit në vetvete, por mënyra e interpretimit të tij mes disa mënyrave interpretuese, ka sjellë si pasojë vendime gjyqësore haptazi në kundërshtim me standardet kushtetuese dhe konventore të të drejtave themelore të njeriut. Po kështu, ky rast kërkon që Gjykata të mos analizojë pretendimet e lidhura me nenin 42 të Kushtetutës vetëm në kuptim procedural, por të analizojë pretendimet për shkeljen e nenit 42 të Kushtetutës si nen garantues i të drejtave substanciale dhe më pas, sipas rastit, të shprehet nëse do të ndalet vetëm në këtë analizë ose do të vazhdojë edhe me pretendimet për shkeljen e të drejtave substanciale të individit. Ndërkohë, po sipas këtij rasti, nëse çështja ngre vetëm problematika të nivelit substancial të të drejtave kushtetuese, ajo duhet trajtuar vetëm sipas kësaj qasjeje detyruese kushtetuese.

6. Nëse juridiksioni dhe kontrolli kushtetues, sipas nenit 131/f të Kushtetutës, do të vazhdojë të kuptohet dhe interpretohet në mënyrë të ngushtë, atëherë kjo do të sillte dy pasoja në vlerësimin tonë: i) mbrojtje joefektive në nivel kushtetues të të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe të drejtën që Kushtetuta ia ka dhënë, do t'ia mohonte jurisprudenca e kësaj Gjykate me interpretim të ngushtuar, duke krijuar e zbatuar një model në kundërshtim me standardet kushtetuese; ii) “konkurrim” të pozicioneve mes Gjykatës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), pasi kjo e fundit, bazuar në KEDNJ dhe jurisprudencën e saj, kontrollon veprimtarinë gjyqësore dhe autoritetet kombëtare si për nenin 6 të KEDNJ-së, si nen procedural, por edhe për nenet substanciale veçmas, pa përjashtuar edhe rastin e kontrollit të standardeve të kërkuara nga neni 6, të lidhur me nene të tjera substanciale (*shih vendimet e GJEDNJ-së, Vigani kundër Shqipërisë, datë 22.11.2022; Fullani kundër Shqipërisë, datë 20.9.2022; Kasmi kundër Shqipërisë, datë 23.6.2020; Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 11.1.2018; Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 13.11.2007*).

7. Për sa më lart, në mënyrë që të shmanget situata ku Gjykata jep një vendim përmes një kontrolli “të ngushtë” dhe GJEDNJ-ja një vendim tjetër, përmes një kontrolli “të zgjeruar”, dhe mund të ekzistojë mundësia që Gjykata të deklarohej si mjet ankimi joefektiv nga GJEDNJ-ja, në vlerësimin tonë, do të duhej që të trajtohej ankimi kushtetues individual si mjet efektiv jo vetëm për të drejtat procedurale, por edhe substanciale, veçmas ose së bashku, në varësi të faktit se si pretendohen nga kërkuesit ose se si mund të paraqiten rrethanat e çështjes konkrete.

8. Nëse do ta analizonim të ndarë procesin për të drejtat procedurale, sipas nenit 42 të Kushtetutës, i cili mund të sjellë efekte dhe tek të drejtat substanciale, si pasojë e orientojmë kontrollin kushtetues në mënyrë të ngushtuar nga pikëpamja kushtetuese. Kjo, pasi procedura mund të sjellë korrigjim të të drejtave substanciale, por jo domosdoshmërisht. Nga ana tjetër, të drejtat procedurale mund të jenë respektuar, por e drejta substanciale mund të jetë cenuar nga veprimtaria e gjykatave të zakonshme. Jo gjithmonë pretendimet substanciale mund të përthithen nga ato procedurale, sikundër shumica argumenton në qëndrimin e saj, dhe që në opinionin tonë nëse do të bëhet qëndrim struktural, orientues për kërkuesit në të ardhmen, mund të krijojë një standard interpretimi ngushtues të garantimit të të drejtave themelore kushtetuese përmes ankimit kushtetues individual.

9. Gjykata ka theksuar se kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Në këto raste, ajo bën një vlerësim

të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 19, datë 7.7.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në vështrim të jurisprudencës së sipërcituar, ankimi kushtetues individual, nëpërmjet të cilit synohet shfuqizimi i vendimeve gjyqësore që kanë ardhur si rezultat i interpretimit antikushtetues të ligjit në zbatim, rrit shanset dhe aksesin e individit në Gjykatë, si mjeti i fundit efektiv për kërkimet e tij përpara se t'i drejtohet GJEDNJ-së, ndaj dhe duhet trajtuar si i tillë. Ndërkohë, shumica e lidh pandashmërisht shqyrtimin e pretendimeve për shkelje të nenit 42 të Kushtetutës me të drejtat substanciale, çka, në vlerësimin tonë, jo detyrimisht mund të jenë të ndërvarura. Shkeljet procedurale mund të riparohen dhe përsëri shkelja substanciale mund të vazhdojë të ekzistojë, ndaj dhe pretendimet duhet të shqyrtohen më vete.

11. Duke iu kthyer rastit konkret, kërkuesi ka pretenduar se vlera e pronës së shpronësuar është disa herë më e lartë sesa ajo e caktuar nga shteti dhe nuk i përgjigjet shpërblimit të plotë të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe neni 153 i KC-së. Sipas tij, kompensimi i drejtë është ai sipas vlerës së tregut. Në caktimin e vlerës së pronës gjykatat nuk kanë marrë parasysh cilësitë e pronës dhe mundësinë e zhvillimit të saj. Për më tepër, gjykatat e kanë dëmtuar më tej, si rrjedhojë e urdhërimit të shtetit për pagimin e shumës me këste (*shih paragrafin 10.2 të vendimit*). Pra, në thelb të pretendimeve të tij, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së pronës private për shkak të vlerës së akorduar për pronën e shpronësuar për interes publik, fillimisht nga VKM-ja nr. 772/2015 dhe më pas nga gjykatat.

12. Ndërkohë që shumica ka zgjedhur t'i trajtojë pretendimet e kërkuesit në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, si dhe të drejtën e pronës, vlerësojmë se ato duhej të trajtoheshin në vendimmarrje në mënyrë autonome, në kuadër të së drejtës së pronës, trajtuar gjatë procesit gjyqësor, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, konkretisht konceptit kushtetues të “shpërblimit të drejtë”, pasi shkaku përcaktues i cenimit nuk është rezultat i drejtpërdrejtë dhe i lidhur ngushtë me procesin procedural të zhvilluar në gjykatat e zakonshme. Një qëndrim i tillë mbështetet edhe nga fakti se çështja e kërkuesit është trajtuar në kuadër të së drejtës për pronë private gjatë gjykimit të saj nga gjykatat e zakonshme, çka është pranuar edhe nga subjektet e interesuara në pretendimet e parashtruara në gjykimin kushtetues të saj, të cilat janë ngritur në kuadër të kësaj të drejte dhe jo të lidhura me të drejtën për proces të rregullt ligjor, siç ka vlerësuar shumica në vendimmarrje.

13. Për sa i përket së drejtës së pronës private, ajo garantohet nga neni 41, pika 1, i Kushtetutës. Ky nen parashikon, ndër të tjera, se ligji mund të parashikojë kufizime në ushtrimin e kësaj të drejte vetëm për interesa publike (*pika 3*) dhe se kufizimet lejohen vetëm përkundrajt një shpërblimi të drejtë (*pika 4*), për masën e të cilit mund të bëhet ankim në gjykatë (*pika 5*), ndërsa sipas nenit 42 të Kushtetutës, prona nuk mund të cenohet pa proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

14. Gjykata ka theksuar se kriteret që parashikon neni 41 i Kushtetutës, që janë garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i përcaktuar nga KEDNJ-ja për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë, janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i së drejtës së pronës. Megjithatë, me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'u nënshtrohet kufizimeve, të cilat duhen bërë sipas disa kriterëve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Ashtu siç ka pranuar edhe shumica, e drejta e pronës, në kuptimin që i jep neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, nuk mund të barazohet me kuptimin që ka në vetvete e drejta dhe se e drejta e pronës nuk mund njësohet me të drejtën e kthimit të saj. Referuar kriterit kushtetues të “shpërblimit të drejtë”, Gjykata ka theksuar se shpërblimi ose kompensimi në dobi të subjektit të shpronësuar nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 4, datë 15.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Objektivat legjitimë të interesit publik, si ato që ndiqen në kuadrin e masave të reformës

ekonomike ose masat e hartuara për të arritur një drejtësi më të madhe shoqërore, mund të kërkojnë një kompensim më të vogël sesa vlera e plotë e tregut.

16. Koncepti i “shpërblimit të drejtë” është trajtuar gjerësisht edhe nga GJEDNJ-ja, e cila ka mbajtur qëndrimin se kushtet e kompensimit, sipas legjislacionit vendas, varen nga vlerësimi nëse masa e ndërmarrë respekton balancën e drejtë dhe nuk vendos një barrë disproporcionale ndaj kërkuarit. Marrja e pasurisë, sipas fjalisë së dytë të paragrafit të parë të nenit 1 të protokollit nr. 1, pa pagesën e një shume që përafrohet në mënyrë të arsyeshme me vlerën e saj, normalisht do të përbëjë një ndërhyrje joproporcionale, ndërsa një mungesë totale e kompensimit mund të konsiderohet e justifikueshme vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Megjithatë, neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk garanton të drejtën për kompensim të plotë në çdo rrethanë, pasi objektivat legjitimë të “interetit publik” mund të kërkojnë një kompensim më të vogël se sa vlera e tregut (*shih vendimet e GJEDNJ-së, Pincová dhe Pinc kundër Republikës Çeke, datë 5.11.2002; Holy Monasteries kundër Greqisë, datë 9.12.1994, § 71; James dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 21.2.1986, § 54*). Kur shpronësimi është rezultat i reformave të mëdha ekonomike ose masave të hartuara për të arritur një drejtësi më të madhe sociale, hapësira e vlerësimit që u jepet shteteve për përcaktimin e shumës së kompensimit është normalisht më e gjerë (*shih vendimin e GJEDNJ-së, Lithgow dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 8.7.1986, § 122*).

17. GJEDNJ-ja e ka mbajtur këtë qëndrim edhe në çështje kundër Shqipërisë, duke theksuar se kushtet e kompensimit, sipas legjislacionit përkatës, janë të rëndësishme për vlerësimin nëse masa e kundërshtuar respekton detyrimin për vendosjen e një balance të drejtë, konkretisht, nëse ajo vendos një barrë joproporcionale mbi individët. Sipas GJEDNJ-së, marrja e pasurisë pa pagesën e një shume të arsyeshme në përputhje me vlerën e saj do të përbëjë një ndërhyrje joproporcionale, ndërsa mungesa totale e kompensimit mund të konsiderohet e justifikueshme sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Megjithatë, ndërsa është e vërtetë se në shumë raste të shpronësimit të ligjshëm vetëm kompensimi i plotë mund të konsiderohet arsyeshmërisht i lidhur me vlerën e pasurisë, neni 1 i protokollit nr. 1 nuk garanton të drejtën për kompensim të plotë në çdo rrethanë. Objektivat legjitimë të “interetit publik”, si ato të ndërmarrja në kuadër të reformave ekonomike ose për arritjen e drejtësisë më të lartë sociale, mund të pranojnë edhe një rimbursim më të vogël se vlera e tregut. Megjithatë, përshtatshmëria e kompensimit do të zvogëlohet nëse do të paguhej pa iu referuar rrethanave të ndryshme që mund të zvogëlojnë vlerën e tij (*shih vendimin e GJEDNJ-së, Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 11.1.2018, §§ 165-168*).

18. Po sipas GJEDNJ-së, marrja e pasurisë pa pagesën e një shume të arsyeshme për vlerën e saj nuk vendos balancën e duhur mes kërkesës së interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit. Kjo balancë përgjithësisht arrihet kur kompensimi, që i jepet personit të cilit i është marrë prona, lidhet në mënyrë të arsyeshme me vlerën e saj të “tregut”, siç është përcaktuar në kohën e shpronësimit, çka nënkupton se shumica e kompensimit për humbjen e titullit të pronësisë për tokën nga ana e palës kërkuuese duhet llogaritur, duke përdorur vlerën e pronës në datën e humbjes së pronësinë (*shih vendimin e GJEDNJ-së, Tunaitis kundër Lituanisë, datë 24.11.2015, §41*). Megjithatë, nëse interesat e komunitetit të realizuara me anë të kufizimit janë me rëndësi të veçantë, raporti i drejtë mund të vendoset edhe pa kompensimin e plotë. Shteteve iu lihet një fushë e gjerë zbatimi e kufirit të vlerësimit, me qëllim miratimin e ligjeve në kontekstin e një ndryshimi të regjimit politik dhe ekonomik që mund të cenojë pronat private dhe, në raste të veçanta, mungesa e kompensimit nuk e bën të paligjshëm veprimin e shtetit për marrjen e pasurisë (*shih vendimin e GJEDNJ-së, Jabn dhe të tjerë kundër Gjermanisë, datë 30.6.2005, §95*).

19. Në rastin e kërkuarit, është e qartë se ndërhyrja në të drejtën e pronës private është bërë me ligj dhe ndjek një qëllim legjitim, atë të përmbushjes së objektivave të interesit publik. Për sa i përket “shpërblimit të drejtë” të përfituar nga kërkuari, në rastin konkret, rezulton se vlerësimi i pronës nga gjykatat është bërë në përputhje me parashikimet ligjore. Në këtë kuptim, ashtu siç është vlerësuar edhe nga shumica, në këndvështrim të proporcionalitetit të ndërhyrjes në të drejtën e pronës private të kërkuarit, sipas nenit 17 të Kushtetutës, çmujmë se vlera e akorduar

atij sipas vendimeve gjyqësore, nuk rezulton të jetë joproporcionale dhe në kundërshtim me konceptin e “shpërblimit të drejtë”, të parashikuar në nenin 41, pika 4, të Kushtetutës.

20. Nga sa më lart, në rastin konkret, rezulton se pretendimet e kërkuarit për shpërblimin e drejtë të pronës së tij janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e zakonshme, të cilat kanë dhënë përgjigje të argumentuar për qëndrimet e tyre. Interpretimet që ato i kanë bërë konceptit kushtetues të “shpërblimit të drejtë”, sipas nenit 41, pika 4, të Kushtetutës, nuk rezultojnë arbitrare në këndvështrimin kushtetues, për rrjedhojë, ashtu si edhe shumica, vlerësojmë se kërkesa e kërkuarit duhet rrëzuar.

Anëtarë: Genti Ibrahimi, Sonila Bejtja, Elsa Toska